

## NJOFTIM PËR KONTRATË

### *Kontratë Furnizimi Procedurë e hapur*

Në përputhje me nenin 10 "Procedura e hapur", të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (1 dhjetor 2024)

#### I BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS – BQK

#### II LËNDA E KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i shpallur nga BQK-ja:

"Furnizim dhe rregullim i ngrohjes qendrore"

II.2 Numërtimi i Prokurimit: "BQK 26 024 121"

#### III VENDI I REALIZIMIT TË SHËRBIMIT

III.1 Vendi i realizimit të kontratës: Objekti i BQK-së, rr. "Luan Haradinaj" nr. 2, 10000 Prishtinë

#### IV KRITERI PËR DHËNIE TË KONTRATËS

IV.1 *Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët* në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK (për më tepër informata referojuni versionit të zgjeruar të njoftimit për kontratë publikuar në [www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet](http://www.bqk-kos.org/shpallje/tenderet)

#### V INFORMATA ADMINISTRATIVE

V.1 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit dhe informata të tjera administrative:

Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit, data: 10.04.2026 ora 12:00 në e-mail adresën: [prokurimi@bqk-kos.org](mailto:prokurimi@bqk-kos.org).

Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë, data: 10.04.2026 ora 12:00.

V.2 Vendi dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderëve, data: 14.04.2026, ora 14:00; Adresa: objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. "Garibaldi" nr. 33, Prishtinë:

V.3 Takimi për hapjen e tenderëve, data: 14.04.2026, ora 14:30; vendi: Objekti i BQK-së, Rr. "Luan Haradinaj" nr. 2., Prishtinë.

V.4 Kushti i sigurimit të tenderit: 1,000.00 € (një/mijë/euro) për periudhë valide prej 90 dite, (dorëzohet me ofertë).

V.5 Kushti i sigurimit të kontratës (do të kërkohet vetëm për tenderuesin e suksesshëm të cilit i jepet kontrata): 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditëve më shumë se sa afati i kontratës.

#### VI INFORMATA PLOTËSUESE

VI.1 Versioni i zgjeruar i njoftimit për kontratë është në dispozicion në ueb-faqen e BQK-së: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)

#### VII ANKESAT

Në përputhje me "Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)", respektivisht sipas Neni 48 "Procedura e ankesës", çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. "Garibaldi" 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t'u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.